



REPUBLICA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE
Nr. Regj. Them 428
Data e ardhjes 12.10.2010

Nr.428 Vendimi
Data 01.11.2010

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE, E PERBERE PREJ :

HERILA ÇELA – GJYQTARE

Asistuar prej sekretares gjyqesore Eglantina Taushani, sot me date 01.11.2010, perfundoi ne séance gjyqesore me dyer te hapura, çeshtjen penale Nr.428 date 12.10.2010, qe i perket

KERKUES :

[REDACTED] i biri i [REDACTED] dhe [REDACTED] datelindja 22.12.1975, lindur dhe banues ne Tirane, adresa: rrg: [REDACTED], perfaqesuar ne gjykim nga av [REDACTED] me prokure te posacme me nr.5432 rep. Nr.792 kol. e dates 11.10.2010.

PALE E INTERESUAR: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, perfaqesuar nga Prokurori [REDACTED]

OBJEKTI :

Kundershtim i vendimit date 04.10.2010, i prokurorit [REDACTED] prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore « Per sekuestrimin e sendeve te Shoqerise Casino Italia, te ndodhura ne ambientet e bar-Restaurant [REDACTED], e cila ndodhet ne fshatin Mullet e Komune [REDACTED] te rrethit te Tiranes.

BAZA LIGJORE :

Neni 287/2 i Kodit penal dhe nenet 212 dhe 218 te Kodit te Procedures Penale.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar ne prani te paleve:

pasi degjoi perfaqesuesin e kerkuesit [redacted] te [redacted] [redacted] te 15 [redacted] [redacted] i cili kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj, si te mbeshtetur ne ligj dhe [redacted] ne prova,

Pasi degjoi palen e interesuar ne kete gjykim, organin e akuzes prokurorine e Rrethit Gjyqesor Vlore te perfaqesuar prej Prokurorit te ceshtjes [redacted] i cili kerkoi;

Rrezimin e kesaj kerkese si te pabazuar ne ligj dhe ne prova,
dhe pasi çmoi dhe vleresoi provat e marra ne seance gjyqesore;

VEREN

Kerkuesi [redacted] me kerkesen e paraqitur perpara Gjykates me objekt gjykimi kerkuar prej saj Kundershtim i vendimit date 04.10.2010, i prokurorit [redacted] dhe Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore « Per sekuestrimin e sendeve te Shoqerise [redacted] te ndodhura ne ambientet e bar-Restaurant [redacted] e cila ndodhet ne [redacted] Mullet e Komunes Petrele te rrethit te Tiranes.

Gjate shqyrtimi gjyqesor te kesaj ceshtje, pas administrimit te te gjitha provave te paraqitura ne kete gjykim, rezultuan te vertetuara;

Rrethanat e Faktit

Ne daten 01.10.2010 Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore ka regjistruar procedimin penal Nr.1516, per kryerjen e vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale" e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Personat te cilet jane nen hetim jane shtetasi italian [redacted] dhe subjekte tjere, te përfshire ne regjistrimin e subjektit tregtar [redacted]. Subjekti tregtar [redacted] i ndodhur ne ambientet e bar-Restaurant [redacted] i cila ndodhet ne [redacted] e Komunes [redacted] te rrethit te Tiranes figuron i regjistrua ne regjistrat e Qendres Kombetare te Regjistrimit me qender ne adresen e sipercituar e cila mban numer identifikimi [redacted] (prove kjo e cila eshte administruar ne dosjen gjyqesore me cilesine e proves shkresore).

Nga te dhenat e grumbulluara nga organi procedues rezulton se ne ambientet e ketij subjektit tregtar gjenden sende te cilat sherbejne per ushtrimin e aktivitetit dhe qe kane lidhje me vepren penale per te cilen procedohet.

Ne daten 04.10.2010 prokurori i kesaj ceshtje prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore me date 04.10.2010 ka vendosur:

"Sekuestrimin e sendeve qe sherbejne per ushtrimin e aktivitetit te [redacted] lajrave te faktit, te cilat ndodhen ne vendin ku ndodhet filiali i subjektit [redacted]"

...sino Italia, i ndodhur ne ambientet e bar-Restaurant... e cila
...ndodhet ne fshati... e Komune... te rrethit te Tiranes ».

Gjate ketij shqyrtimi gjyqesor, rezultoi e provuar se me date 04.10.2010, ora
18:40min eshte kryer ekzekutimi i vendimit, duke u sekuestruar sendet sipas
protokolit verbalit "Per ekzekutimi i vendimit te sekuestrimit" te Prokurorise se rrethit
Gjyqesor Tirane (prove kjo e cila eshte e dministruar ne dosje me cilesine e proves
shkresore).

Ne daten 12.10.2010 kerkuesi... ka paraqitur kerkesen objekt gjykimi,
Tirane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

II. Pretendimet e Paleve

Kerkuesi ka pretenduar se vendimi i sekuestrimit eshte i padrejte per shkak te
interpretimit te rrethanave te faktit. Sendet e sekuestruara nuk i perkasin shoqerise
tregtar... apo personit nen hetim, po keto sende te sekuestruara, pra objekt i
vendimit te sekuestros jane pasuri e kerkuesit...

Kerkuesi... pretendon qe resorti... eshte ambient ne
sedimin e tij si rrjedhoje e kontratës se qirase e cila mban daten 09.04.2009, me
nr.0505 repertori dhe nr.395 koleksioni, ka qenë nen aktivitet tregtar ne periudhen 2007-
2010 dhe aktualisht eshte nen rikonstrukcion.

Kerkuesi pretendon gjithashtu se midis tij dhe shoqerise... apo
shitetasit... nuk ka asnje maredhenie juridike dhe te dy keto subjekte
tregtare apo fizike, nuk ushtrojne asnje lloj aktiviteti ne ambientet e Resortit...

Organi procedues, nepermjet perfaqesuesit te tij ka parashtruar se ne ambientet e
subjektit tregtar gjenden sende te cilat sherbejne per ushtimin e aktivitetit dhe qe kane
lidhje me vepren penale per te cilen procedohet dhe konkretisht ate te "Pastrimit te
produkteve te vepres penale" te parashikuar nga nenin 287 i Kodit Penal.

Nga ana e organit te akuzes eshte vleresuar se gjenden kushtet e parashikuara ne
nenin 208 i Kodit te Procedures Penale, dispozite ligjore kjo e cila shprehimisht
parashikon:

*"Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar
sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën
penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.*

*Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e
policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.*

*Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se
është i pranishëm."*

III. Në lidhje me provat

Per vertetimin e pretendimeve te tij kerkuesi ka paraqitur ne cilesine e provave
sore provat si me poshte:

- Kontrate qeraje e cila mban daten 09.04.2009, me nr.1505 repertori dhe nr.395 koleksioni.
- Fature e thjeshte tatimore me nr.23 e dates 06.09.2010, me nr.0001950.
- Vendim i sekuestrimit i dates 04.10.2010, bashkangjitur me process-verbalin "Per ekzekutimin e vendimit te sekuestrimit" te dates 04.10.2010 ora 18.40min.

IV. Argumentimi ligjor

Veprimtaria procedurale e ndermare nga prokurori, me qellim sekuestrimin e materiale dhe te sendeve qe lidhen me vepren penale gjendet e bazuar ne fakt dhe Ne keto kushte kjo rrethane passjell rrezimin e kerkeses te paraqitur prej kerkuesit

Baza ligjore e perdorur nga organi i akuzes per urdherimin e sekuestros jane dispozitat ligjore dhe konkretisht nenet 208 pika 1 i Kodit te Procedures Penale dhe 287, pika 2 te Kodit Penal.

Keto dispozita shprehimisht citojne:

"Gjyqtari ose prokurori disponojne me vendim te arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe te sendeve qe lidhen me veprën penale kur ato jane të domosdoshme për vërtetimin e fakteve..."

Neni 287/2 te Kodit Penal

"1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale."

Faktet e pretenduara te cilat kane lejuar dhe mundesuar marrjen e mases perbejne ushtrim te aktivitetit te kunderligjshem ne formen e vepres penale.

Sendet e sekuestruara kane vleren e burimit te proves ose te proves materiale per vertetimin e nje veprimtarie te kunderligjshme. Sekuestrimi i sendeve qe lidhen me vepren penale nuk kushtezohet nga fajesia penale e subjekteve te caktuar, gjithashtu nuk kushtezohet me titullin e pronesise apo te posedimit mbi keto sende.

Pavaresisht, vertetesise se pretendimeve te kerkuesit ne lidhje me gjendjen e faktit, zoterimin e sendit apo perkatesine e pronesise, sekuestrimi i sendeve ka qene i domosdoshem per tu perdorur ato, pra sendet ne cilesine e provave qe mund te sherbejne per vertetimin e nje veprimtarie te kunderligjshme.

sekuestrimit është i lejueshem dhe i mundur kur vertetohet lidhja midis sendeve dhe
penale.
Pretendimet e tjera të kerkuesit në lidhje me përgjegjësinë penale, në pjesëmarrjen
apo jo në aktivitete të kundershtime të cilat përbejnë apo jo vepra penale, nuk janë
objekt i këtij gjykimi.

Në kushtet kur sekuestrimit i sendeve nuk ka qenë i lidhur dhe rrjedhojë e
pjesëmarrjes apo jo në veprat penale të kerkuesit, pretendimet e kerkuesit të parashtruara
në kërkesë në lidhje me këto shkaqe gjenden të pabazuara.

Rrethanat e faktit të pretenduara në vendimin e sekuestros, natyra e sendeve të
sekustruara vertetohen në mënyrë të padyshimte lidhjen e sendeve të sekuestruara me
veprat penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurës Penale;


VENDOSI

- Rrezimin e kërkesës së kerkuesit [redacted] me palë të interesuar
Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt « Kundershtim i vendimit datë
04.10.2010, i prokurorit [redacted] pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë
«Per sekuestrimit të sendeve të Shoqërisë [redacted] të ndodhura në ambientet e
bar-Restaurant [redacted] e cila ndodhet në fshatin [redacted] e Komunes Petrele të
rrethit të Tiranës.

- Kunder këtij vendimi lejohet ankimi brenda afatëve ligjore në Gjykatën e
Apelit Vlorë.

U shpall në Vlorë me datë 01.11.2010

SEKRETARE
EGLANTINA TAUSHANI



GJYQTARE
HERILA ÇELA



Vendimi mori forme te prere me vendimin nr 203 date 02.12.2010 te Gjykates
se Apelit Vlore e cila ka vendosur:
Mospranim ankimi

**KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI**

Me vendimi e Gjykates se Larte Kolegji penal nr 49 date 09.03.2011 eshte
vendosur :

Prishjen e vendimit nr 203 date 02.12.2010 te Gjykates se Apelit
Vlore dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim ne ate Gjykate , me tjetër trup
gjyqes.

**KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI**

Vendimi mori forme te prere me vendimin nr 75 date 20.04.2011, te Gjykates se
Apelit Vlore e cila ka vendosur :
Lenien ne fuqi te vendimit nr 428 01.11.2010 te Gjykates rrethit
Gjyqesor Vlore.

**KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI**